FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 11

Tiranë – E premte, 2 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 31.1.2018	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 20.9.2017, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, institucion i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016", të ndryshuar, dhe nr. 497, datë 13.9.2017, "Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, nga Ministria e Kulturës Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016".....	375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 31.1.2018	Për kompensimin e qirasë së banesës për strehimin e prokurorit të caktuar të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm.....	375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 31.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar.....	376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 31.1.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 499, datë 19.7.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Divjakë, të qarkut të Fierit, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar".....	377

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 31.1.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 786, datë 9.11.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike".....	385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 52, datë 31.1.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 218, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe rregullave për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur, me lejet ekzistuese dhe ndryshimin e koordinatave për lejet minerare të përcaktuara në hapësirë me tri koordinata".....	386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 31.1.2018	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të veprës së artit në pikturë "Mbjellja e pemëve", të autorit Edi Hila, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, e cila do të jetë pjesë e ekspozitës "Edi Hila-Monography", që organizohet në Muzeun e Artit Modern në Varshavë, Poloni.....	386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 31.1.2018	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.....	387
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 4450/6, datë 29.1.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: "Sistemim, asfaltim i rrugës "Belul Berisha", në Bashkinë e Elbasanit.....	390
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 5088/13, datë 29.1.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i bllokut të pallateve në Xhabije", Bashkia Shkodër.....	390
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu.....	392
	Korrigjim gabimi në udhëzimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 32, datë 29.12.2017, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 246/2017, datë 24.1.2018.....	392

VENDIM
Nr. 46, datë 31.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 518, DATË 20.9.2017, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË NJË PJESE TË GODINËS KU USHTRON VEPRIMTARINË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT, PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT, INSTITUCION I RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, I PARASHIKUAR NGA LIGJI NR. 84/2016", TË NDRYSHUAR, DHE NR. 497, DATË 13.9.2017, "PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË ISH-GODINËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE, NGA MINISTRIA E KULTURËS KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE KOMISIONERËVE PUBLIKË, INSTITUCIONE TË RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR. 84/2016"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 10, 13, 14 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titull dhe në pikën 1, të vendimit nr. 518, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "... Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, institucion i rivlerësimit ..." zëvendësohen me "... Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit ...".

2. Në titull dhe në përmbajtje të vendimit nr. 497, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... dhe Komisionerëve Publikë ..." shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës dhe Komisionerët Publikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 47, datë 31.1.2018

PËR KOMPENSIMIN E QIRASË SË BANESËS PËR STREHIMIN E PROKURORIT TË CAKTUAR TË KRYEJË PËRKOHËSISHT DETYRËN DHE FUNKSIONET E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin, në masën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, të pagesës së qirasë së banesës për strehimin, në qytetin e Tiranës, të prokurorit të caktuar të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Pagesa e kompensimit, deri në përfundim të periudhës së përkohshme, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të kryhet çdo muaj, me fondet e buxhetit të miratuar për vitin 2018 për Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Shuma e përgjithshme e fondit, që do të përdoret për pagesat e kompensimit, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe të rishpërndahet në buxhetin e miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme.

4. Ngarkohen Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 48, datë 31.1.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës, me emërtimin "Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit", zëvendësohen me përmasat e përcaktuara sipas formularit me 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Institucioni Qendror: **Ministria e Puneve te Brendshme**
Qendra e Sherbimit dhe Administrimit te Mjeteve te Transportit

Identifikoi: **Besnik Çina** (Drejtor I Programimit te Buxhetit dhe Finances)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia Tirane

Aprovoi **Vait Sinaj** (Drejtor I Pergjithshem ne QSHAMT)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e perdorimit te Prones: Sherbime

		A			B				C		
Nr. Rend	Nr. Rend sipas VKM	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m^2	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te fjera (Shenime te veçanta)
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				QSHAMT (ish oficina e MB)		Rruga Irfan Tomini Tirane	9825.54 m2		MPB	QSHAMT	
2				Rruga Irfan Tomini Tirane	Godine 1 kat	Pike rafenimi	1315.78	Rep riparim vetura+furgona	MPB	QSHAMT	
3					Godine 2 kat	Veri	322.8	Zyra+Magazina	MPB	QSHAMT	
4					Godine 1 kat	Lindje	521.43	Rep Kamjonave	MPB	QSHAMT	
5					Godine 1 kat	Jug - Perendim	161.7	Repart	MPB	QSHAMT	
6					Godine 1 kat	Veri - Perendim	879	Repart+ magazine	MPB	QSHAMT	
7					Godine 1 kat	Jug	446.86	Lokal	MPB	QSHAMT	
8					Godine 1 kat	Lindje	309.5	Magazine	MPB	QSHAMT	
9					Godine 1 kat	Jug-Lindje	532.7	Rep Motorrist	MPB	QSHAMT	
10					Truall i liré	Perendim	2859.84	Truall i liré	MPB	QSHAMT	
11					Truall i liré	Lindje	1228	Truall i liré	MPB	QSHAMT	
12					Truall i liré	Veri	1247.93	Truall i liré	MPB	QSHAMT	

VENDIM
Nr. 49, datë 31.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 499, DATË 19.7.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DIVJAKË, TË QARKUT TË FIERIT, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 8/a, shkronja "a", të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Në vendimin nr. 499, datë 19.7.2006, të Këshillit të Ministrave, dhe në listën e inventarit bashkëlidhur bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pronave me nr. 558, 559, 560, 561, 562, 563, 564, 568, 569, 570, 571-581, u ndryshon fusha e përdorimit nga "Mbrojtje kombëtare" në fushën e "Zhvillimit ekonomik", sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë Bashkisë Divjakë për pronat me nr. 565, 566 dhe 567.

c) Në listën e inventarit shtohen pronat me nr. 724-744, të cilat i transferohen në përdorim Bashkisë Divjakë, sipas formularëve dhe lidhjes 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqen pronat me nr. 1349, 1350, 1351, 1352, 1353, 1354, 1355, 1356, 1357, 1358, 1359 dhe 1360, me emërtimin "Pasuri në funksion për mbrojtjen", me vendndodhje në Divjakë.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Bashkia Divjakë Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
558, 559, 560, 561, 562, 563, 564, 568, 569, 570, 571-581	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
724-744	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Institucioni I Pushtetit Qendror: **Ministria e Mbrojtjes**

Bashkia: **Divjake**

Fusha e perdorimit te Prones: **Mbrojtje**

Identifikoi: **Spiro Sako Miranda Qamo** (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: **Rudina Ndoni** (P/Zyres se Urbanistikes)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Irakli Gorreja** Kryetar i Bashkise
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A		B				C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m^2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
558	3848 K-37-112 B-18	907/24	Batalioni i Kembesorise Bashkia Divjake			1600m2	Per Mbrojtjen	MM Rep. Usht 8800 Tirane	Rep. Usht 6620 Fier	Proçes privatizimi Funksionon si kishe Kisha Shen Nikollit
559				Fjetore efektivi	Divjake	320	Per Mbrojtjen	"	Rep. Usht 6620 Fier	
560				Truall	Divjake	1080	Per Mbrojtjen	"	Rep. Usht 6620 Fier	
561				Rruge te brëndshme	Divjake	200	Per Mbrojtjen	"	Rep. Usht 6620 Fier	

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
562	K-34-112 C-34 2700	2055/ 13-H5	Bateria KA Bashkia Divjake			2500m2	Mbrojtje	MM Rep. Usht 8800 Tirane	Rep. Usht 6620 Fier	Proçes privatizimi
563				Truproje tip i madh	Bishti i Gogles	144	Mbrojtje	"	"	Proçes privatizimi
564				Terren ne funksion	Bishti i Gogles	2356	Mbrojtje	"	"	Territor I lire
565	1492 K34-100 D-241	609/27	Ish Batalion mitralier Bashkia Divjake			800m2	Mbrojtje	MM Rep. Usht 8800 Tirane	Rep. Usht 6620 Fier	Jashte funksioni
566				Zyre komande	Divjake	300	Mbrojtje	"	"	
567				Truall	Divjake	500	Mbrojtje	"	"	
568	1492	28	Poligon qitje e AKA Bashkia Divjake			23030m2	Mbrojtje	MM Rep. Usht 3400 Tirane	Rep. Usht 3400 Tirane	Territor i lire Ndertesa zene forcerisht
569				Poligon	Divjake	23000	Mbrojtje	"	"	

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
570				Ndertese	Divjake	30	Mbrojtje	"	"	Zënë forcërisht
571	1492 K-34-112 2-B	658/13	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	2550	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	
572	1492 K34-100 243-C	669/330	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	2000	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	
573	1492 K-34-112 3-A	669/331	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	1500	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	
574	1492 K-34-112 2-D	889/36	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	3200	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	
575	1193 K34-100 242-D	57/7	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	5600	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	
576	1492 K34-100 243-C	669/ 339	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	9800	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	
577	1492 K-34-112 2-B	685/75	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	3500	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
578	1492 K-34-112 2-B	790/ 240	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	2500	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes
579	1492 K34-100 242-D	474/ 120	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	900	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes
580	1492 K34-112 2-B	656/ 64	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	2500	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes
581	1492 K34-100 243-C	669/ 327	Vendstrehim i nendheshem Bashkia Divjake	Tunel	Kodrat Divjake	11500	Sherbim i Artilerise se Rënde	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Bashkia / Komuna: Bashkia Divjakë

Fusha e perdorimit te Prones: Bujqësi

Identifikoi: Dorjan SPAHO (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Përgjegjës Kadastre

Supervizoi: Llazar VODO (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit

Aprovoi: Fredi KOKONESHI (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula) Kryetari i Bashkisë

	A		B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m^2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
724	K-34-100-242-A	450/12 Vol.48 fq.72	Divjakë	Truall	Divjakë	3624	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
725	K-34-100-242-A	450/13 vol.48 fq.73	Divjakë	Truall	Divjakë	4000	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
726	K-34-100-242-A	450/14 vol.48 fq.74	Divjakë	Truall	Divjakë	3960	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
727	K-34-100-242-A	450/15 vol.48 fq.75	Divjakë	Truall	Divjakë	5500	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
728	K-34-100-242-A	450/16 Vol.48 fq.76	Divjakë	Truall	Divjakë	5307	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
729	K-34-100-242-A	450/17 Vol.48 fq.77	Divjakë	Truall	Divjakë	5307	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
730	K-34-100-242-A	450/18 Vol.48 fq.78	Divjakë	Truall	Divjakë	5302	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
731	K-34-100-242-A	450/19 Vol.48 fq.79	Divjakë	Truall	Divjakë	4040	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
732	K-34-100-242-A	450/20 Vol.48 fq.80	Divjakë	Truall	Divjakë	6000	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
733	K-34-100-242-A	450/21 Vol.48 fq.81	Divjakë	Truall	Divjakë	2700	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
734	K-34-100-242-A	450/22 Vol.48 fq.82	Divjakë	Truall	Divjakë	2700	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
735	K-34-100-242-A	450/23 Vol.48 fq.83	Divjakë	Truall	Divjakë	11 560	Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
736	K-34-100-242-A	450/37 Vol.52 fq.131	Divjakë	Arë + Truall Arë Truall	Divjakë	119 922 116922 3000	Bujqësi Zhvillim ekonomik	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
737	K-34-100-242-A	448/39 vol.35 fq.153	Divjakë	Arë	Divjakë	34 440	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
738	K-34-112-2 - B	792/11 vol.37 fq.244	Divjakë	Arë	Divjakë	19 000	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
739	K-34-112-1 - C	821/46 vol.49 fq.177	Divjakë	Arë	Divjakë	157 888	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
740	K-34-112-1 - C	822/34 vol.48 fq.241	Divjakë	Arë	Divjakë	650 638	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
741	K-34-100-241 - C	240/9 vol.35 fq.26	Divjakë	Arë	Divjakë	59 033	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
742	K-34-100-241 - C	264/30 vol.49 fq.123	Divjakë	Arë	Divjakë	28 757	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
743	K-34-100-241 - C	211/67 vol.35 fq.7	Divjakë	Arë	Divjakë	27 125	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	
744	K-34-112-1 - A	275/8 vol.35 fq.48	Divjakë	Arë	Divjakë	5 775	Bujqësi	Bashkia Divjakë	Min. e Bujqësisë	

VENDIM
Nr. 51, datë 31.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 786, DATË 9.11.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE RASTET E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE SI DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 9, e 60, pika 1, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 786, datë 9.11.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në kreun IV, "Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të bordit", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Kryetari dhe anëtarët e bordit shpërblehen çdo muaj, në një masë, të paktën, të barabartë, por jo më shumë se 10 për qind më të lartë se masa e shpërblimit të anëtarëve të këshillit drejtues të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të bordit. Pagesa, për këtë qëllim, sigurohet nga të ardhurat e tjera të bordit (jo nëpërmjet buxhetit të shtetit), në përputhje me rregulloren mbi të ardhurat, të miratuar prej tij.".

ii) Pas pikës 12 shtohen pikat 12.1 e 12.2, me këtë përmbajtje:

"12.1. Në rastet kur bordi kërkon financim nga buxheti i shtetit, atëherë shpërblimi i anëtarëve të tij do të jetë në masën e përcaktuar në aktin ligjor në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

12.2. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë raporton pranë bordit, brenda muajit janar të çdo viti, shumat e honorareve për këshillin drejtues, të cilat do të shërbejnë si referencë për përcaktimin e shpërblimeve të anëtarëve të bordit.".

iii) Pas pikës 13 shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

"14. Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është organi që përfaqëson bordin.".

b) Pas kreut IV shtohet kreu IV/1, me këtë përmbajtje:

"IV/1. Mënyra e funksionimit dhe niveli i pagave të strukturës mbështetëse

1. Bordi, në ushtrimin e funksioneve të veta mbikëqyrëse, të sigurimit të cilësisë dhe administrative, asistohet nga një strukturë mbështetëse. Struktura mbështetëse përbëhet nga personeli i përhershëm dhe nga komisionet e grupet e punës të ngritura nga bordi. Personeli i përhershëm i strukturës mbështetëse do të përbëhet nga jo më pak se 10 punonjës, përkatësisht, 1 drejtor ekzekutiv, minimalisht 5 inspektorë të lartë, që do të angazhohen në kontrollin e sigurimit të cilësisë, si dhe, të paktën, 4 punonjës administrativë mbështetës.

2. Bordi, në përputhje me pikën 8, të nenit 4, të ligjit, për përmbushjen e funksioneve të veta miraton organikën e strukturës mbështetëse, në përputhje me praktikat më të mira të institucioneve homologe, si dhe me të ardhurat e siguruara.

3. Në përputhje me pikën 6, të nenit 4, të ligjit, bordi mund të angazhojë ekspertë të jashtëm për të kryer kontrolle cilësie specifike apo për çështje të tjera, të lidhura me kontrollin e cilësisë.

4. Kriteret e përzgjedhjes së ekspertëve të jashtëm përcaktohen në rregulloren e miratuar nga bordi, në përputhje me shkronjat "a" dhe "c", të pikës 5, të nenit 4, të ligjit.

5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të strukturës mbështetëse rregullohen në përputhje me Kodin e Punës, sipas pikës 8, të nenit 4, të ligjit. Procedura e detajuar e emërimit të punonjësve dhe detyrat që duhet të përmbushë stafi i strukturës mbështetëse përcaktohen në rregulloren e hartuar nga bordi.

6. Niveli bazë i pagave të stafit të strukturës mbështetëse do të ketë si referencë strukturën e pagave për nëpunësit civilë, të barasvlershme me funksionet, si më poshtë vijon:

a) Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i barasvlershëm me funksionin "Drejtor i Përgjithshëm në ministri", në kategorinë II-a;

b) Inspektor i lartë për kontrollin e sigurimit të cilësisë, i barasvlershëm me funksionin "Drejtor drejtorie në ministri", në kategorinë II-b;

c) Specialist në administratën e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i barasvlershëm me funksionin "Specialist në ministri";

ç) Punonjësit mbështetës kanë strukturën e pagës së punonjësve mbështetës në administratën publike.

7. Bordi përcakton në rregullore kriteret e shpërblimit nga të ardhurat e veta për strukturën mbështetëse, por jo më shumë se dy paga në vit.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 52, datë 31.1.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 218, DATË 11.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE RREGULLAVE PËR SHFRYTËZIMIN, NË SIPËRFAQE DHE NËNTOKË, TË ZONAVE QË JANË NGJITUR, ME LEJET EKZISTUESE DHE NDRYSHIMIN E KOORDINATAVE PËR LEJET MINERARE TË PËRCAKTUARA NË HAPËSIRË ME TRI KOORDINATA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 1, dhe 57, pika 2/1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 218, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

I. Në kreun I bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës "c", të pikës 1, shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) nga AKBN-ja dhe AKSEM-i vlerësohet se shfrytëzimi i rezervave të mineralit mbi dhe nën lejen ekzistuese fqinje paraqet vështirësi teknike dhe rrezikshmëri për t'u realizuar nga ana e subjektit fqinj.".

2. Pika 6 riformulohet, si më poshtë vijon:

"6. Afati i vlefshmërisë së lejes për shfrytëzimin në sipërfaqe dhe nëntokë të zonave që janë ngjitur me lejen ekzistuese do të jetë periudha e mbetur e lejes ekzistuese.".

3. Fjalia e parë, e pikës 9, riformulohet, si më poshtë vijon:

"Prodhimi për sipërfaqen shtesë duhet të llogaritet deri në afatin e mbetur të lejes ekzistuese.".

II. Pika 2, në kreun III, riformulohet, me këtë përmbajtje:

"2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 53, datë 31.1.2018

PËR LEJIMIN E LËVIZJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË VEPRËS SË ARTIT NË PIKTURË "MBJELLJA E PEMËVE", TË AUTORIT EDI HILA, PJESË E FONDIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE, E CILA DO TË JETË PJESË E EKSPOZITËS "EDI HILA-MONOGRAPHY", QË ORGANIZOHET NË MUZEUN E ARTIT MODERN NË VARSHAVË, POLONI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të veprës së artit në pikturë "Mbjellja e pemëve", të autorit Edi Hila, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, për t'u paraqitur në ekspozitën "Edi Hila-Monography", në Muzeun e Artit Modern në Varshavë, Poloni, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimi i lëvizjes së veprës të bëhet për periudhën 1 shkurt-15 qershor 2018.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".

4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprës në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së veprës.

5. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI I

Lista e veprës

Nr.	Nr.inv.	Emri i autorit	Titulli i veprës	Përmasat	Teknika	Materiali	Viti	Çmimi në lekë
1	1307	Edi Hila	Mbjellja e pemëve	150 x 199 cm	Vaj	Kanavacë	1971	350.000

VENDIM
Nr. 54, datë 31.1.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 35, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 201, datë 16.3.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Shtetit për Diasporën, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shoqata për Autonomi Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ushtron veprimtarinë e tij bazuar në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e OKB-së Mbi të Drejtat e Fëmijës, marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe në

parimet e parashikuara në nenet 5 e 6, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

1.2 Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me funksionimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

1.3 Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet edhe shkurtimet e mëposhtme:

- "Këshilli" - Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- "Agjencia" - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- "Sekretariati"- Sekretariati teknik i këshillit;
- "OJF" - Organizatë jofitimprurëse;
- "Ligji" - Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- "Ministri bashkërendues" - Ministri përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

II. Emërimi i anëtarit dhe mandati i tij

2.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në përbërje të tij ka si anëtarë ministrat e përcaktuar nga Kryeministri, në përputhje me pikën 3, të nenit 35, të ligjit, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi vendore dhe 5 përfaqësues të shoqërisë civile.

2.2 Mandati i anëtarëve të Këshillit përfundon:

a) me plotësimin e afatit 4-vjeçar;

b) me lirimin nga detyra, për shkak të së cilës ishte anëtar i Këshillit sipas ligjit;

c) në rast dorëheqjeje të përfaqësuesit të Shoqatës për Autonomi Vendore ose të shoqërisë civile. Në këtë rast njoftohet nga sekretariati teknik Shoqata për Autonomi Vendore ose Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, të cilët marrin masa për emërimin e përfaqësuesit/ve të ri/rinj në Këshill, brenda 1 (një) muaji, duke ia komunikuar këtë ministrit bashkërendues;

ç) në rast të mospjesëmarrjes së personit përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore dhe të shoqërisë civile në dy mbledhje të Këshillit në një vit kalendarik.

2.3 Ministri bashkërendues merr masat e nevojshme për ripërtëritjen e anëtarësisë së Këshillit, në rastin e përfundimit të mandatit të anëtarit.

III. MBLEDHJET E KËSHILLIT

3.1 Këshilli mblidhet të paktën 2 herë në vit, me qëllim realizimin e detyrave të përcaktuara në nenet 36 e 37, të ligjit.

3.2 Mbledhja e parë e Këshillit realizohet pa pjesëmarrjen e anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile. Në këtë mbledhje, Këshilli miraton udhëzimin për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, sipas pikës 7, të nenit 35, të ligjit.

3.3 Këshilli Kombëtar ka të drejtë të ngrejë komitete teknike këshilluese për çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të përcaktojë me udhëzim përbërjen dhe rregulloret e tyre.

3.4 Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverisë së nxënësve, organizatave, forumeve, apo çdo grupimi tjetër fëmijësh. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës bëhet me udhëzim të Këshillit.

3.5 Këshilli, në një nga mbledhjet e tij, diskuton lidhur edhe me:

a) raportin e zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020;

b) planifikimin e aktiviteteve dhe të buxhetit për zbatimin e agjendës;

c) financimin nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera nga donatorët.

3.6 Ministri bashkërendues është kryetar i Këshillit, i cili e kryeson dhe e drejton mbledhjen e Këshillit. Ai ka të drejtë të mbledhë Këshillin:

a) në çdo rast që e sheh të arsyeshme, bazuar në situata që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre;

b) kur ka nevojë për ndryshime në politika, në legjislacion, apo për koordinim ndërinstitucional;

c) në rastet e rishikimit/pranimit të raporteve të veçanta për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të hartuara nga institucionet që janë anëtarë të Këshillit.

3.7 Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Këshillit me një kërkesë të argumentuar me shkrim drejtuar kryetarit të Këshillit, ku propozon dhe afatin kohor për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit. Kryetari, pasi shqyrton kërkesën, merr vendimin për mbledhjen ose jo të Këshillit dhe njofton anëtarin që ka kërkuar mbledhjen e Këshillit.

3.8 Kryetari i Këshillit miraton rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit, e cila u dërgohet 15 ditë më parë anëtarëve, përfaqësuesve të Këshillit. Ndryshimi i kohës dhe i vendit të mbledhjes së

Këshillit iu njoftohet anëtarëve, jo më vonë se 5 ditë përpara mbledhjes.

3.9 Struktura politikëbërëse në ministrinë bashkërenduese për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe secili anëtar i Këshillit, i propozon ministrit bashkërendues përfshirjen e një çështjeje në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit, të paktën 7 ditë dhe jo më vonë se 2 ditë për çështjet urgjente, përpara datës së mbledhjes. Anëtari i bashkëlidh propozimit të tij edhe argumentimin shpjegues për nevojën e diskutimit të çështjes, si dhe dokumentet mbështetëse, nëse ka.

Mbledhja e Këshillit mbahet kur janë prezentë të paktën 2/3 e anëtarëve. Nëse në mbledhjet e Këshillit nuk janë prezentë 2/3 e anëtarëve, mbledhja nuk zhvillohet dhe kryetari vendos të thërrasë mbledhjen brenda 10 ditëve.

3.10 Propozimet dhe rekomandimet votohen në formë të hapur dhe miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve prezent në mbledhje. Vota e kryetarit të Këshillit është vendimtare, nëse rezultati i votimit është i barabartë.

3.11 Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit duke ushtruar detyrën e tyre funksionale pa pagesë/shpërblim.

3.12 Kryetari i Këshillit ka të drejtë t'u tërheqë vëmendjen anëtarëve për ruajtjen e etikës, kur krijohen situata të cilat pengojnë vijueshmërinë e mbledhjes së Këshillit. Në rastet kur bëhet e pamundur zhvillimi i mbledhjes, Kryetari vendos për mbyllen e saj.

IV. SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT

4.1 Sekretariati i Këshillit përbëhet nga 1 (një) nëpunës që mbulon çështjet e fëmijëve në strukturën përkatëse politikëbërëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 2 (dy) nëpunës nga agjencia.

Sekretariati mbështet funksionimin dhe realizimin e detyrave të Këshillit për:

a) organizimin e mbledhjeve;

b) dërgimin e rendit të ditës, së bashku me dokumentet mbështetëse tek anëtaret dhe vëzhguesit;

c) përfshirjen e çështjeve të propozuara nga anëtarët në rendin e ditës së mbledhjes së radhës të Këshillit;

ç) njoftimin e anëtarit propozues, nëse nuk përfshin një çështje në rendin e ditës, së bashku me argumentimin përkatës;

d) përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve urgjente të propozuara nga anëtaret dhe bën shpjegimin përkatës për këto çështje në fillim të mbledhjes;

dh) mbajtjen e procesverbalit - dokumentimin e diskutimeve, votimeve, rekomandimeve dhe propozimeve të Këshillit gjatë mbledhjeve. Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet për rekomandime e propozime firmosen nga kryetari i Këshillit;

e) mbajtjen e regjistrit të mandateve të anëtarëve;

ë) përgatitjen, koordinimin e hartimit të dokumenteve me institucionet dhe strukturat përgjegjëse për çështjet që do të diskutohen në rendin e ditës;

f) garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve, sipas udhëzimit të Këshillit, bazuar në pikën 7, të nenit 35, të ligjit;

g) raportimin e progresit, të rezultateve apo të produkteve të punës së Komitetit Teknik të Përhershëm për çështje të caktuara;

gj) raportimin e statusit të zbatimit të propozimeve dhe të rekomandimeve të marra nga Këshilli në mbledhjet paraardhëse.

4.2 Sekretariati teknik dokumenton në një regjistër të posaçëm emërimin, zëvendësimin, kohën e mandatit të secilit anëtar dhe pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Këshillit. Sekretariati i informon anëtarët e Këshillit 6 muaj përpara përfundimit të mandatit.

V. NDJEKJA DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE PROPOZIMEVE TË KËSHILLIT

5.1 Ministri bashkërendues, me ndihmën e strukturës së politikëbërjes në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe agjenci, merr masa për monitorimin, ndjekjen apo/dhe zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, në periudhën mes dy mbledhjeve të Këshillit.

5.2 Ministri bashkërendues ose agjencia, me delegimin e ministrit bashkërendues, raportojnë në mbledhjen e radhës se Këshillit për ecurinë, progresin, sfidat e hasura apo nevojën për ndryshim në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve apo të propozimeve të bëra nga Këshilli në mbledhjen paraardhëse.

KËRKESË
Nr. 4450/6, datë 29.1.2018

SHPALLJE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: "Sistemim, asfaltim i rrugës "Belul Berisha", në Bashkinë e Elbasanit.

Subjekti kërkues është Bashkia e Elbasanit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 1.333.126 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË CILAT PREKEN NGA OBJEKTI:
"SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGËS BELUL BERISHA", ELBASAN

			Vërtetim pronësie			Truall			Banesa				Shpronësimi	
			m²						Sip. e banes m²		Çmimi	Shpron.		
Nr.	Familja që shpronësohet	Nr. i pasur.	truall	banesë	njësi	Shpron. m²	Çmimi lekë/m²	Shpron. lekë	preket	shpro.	lekë/m²	lekë	Shuma lekë	Vërejtje
1	Malvin Sefer Shuka	22/179	118,00	45.90	0,00	38.00	12764	485032.00	17.00	0.00	40878	694926.00	1179958.00	Konfir. ZVRPP
2	Zylyftar Shefqet Mujo	22/140	299,70	133.60	0,00	12.00	12764	153168.00	0.00	0.00	40878	0.00	153168.00	Konfir. ZVRPP
					0,00	50.00		638200.00				694926.00	**1333126.00**	

KËRKESË
Nr. 5088/13, datë 29.1.2018

SHPALLJE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i bllokut të pallateve në Xhabije", Bashkia Shkodër.

Subjekti kërkues është Bashkia Shkodër. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është: 25 706 471.8 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit "Rikonstruksion i bllokut të pallateve Xhabije"
Bashkia Shkodër

Nr.	Emri Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Vol	Sipërfaqe totale m²	Nga kjo s. trualli m²	Çmimi truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sip. ndërtimi m²	Çmimi i ndërtesës lekë/m²	Vlera e ndërtesës lekë	Vlera totale	Shënime
1	Bujar Zeneli	Sh-0-6	1/533	28	89.25	89.25			89.25	58,687.50	5,237,859.38	5,237,859.4	Konfirmim ZVRPP Shkodër
2	Martin Kodra		1/755	38	25.9	25.9			25.9	58,687.5	1,520,006.25	1,520,006.3	Konfirmim ZVRPP Shkodër
3	Lekë Lekaj		1/745		18	18			18	58,687.5	1,056,375.00	1,056,375.0	Vërtetim nga dok. hipotekor
4	Vaçe Mlika Valbona Topaku	SH-P-6	1/790	38	37.9	37.9			37.9	58,687.5	2,224,256.25	2,224,256.3	Vërtetim nga dok. hipotekor
5	Ruzhdi Pjeshka Pranvera Pjeshka	SH-0-6	1/943	36		35	12,223	427,805.0				427,805.0	Vërtetim nga dok. hipotekor
6	Isuf Haxhija	SH-0-7	1/935	35		90	12,223	1,100,070.0				1,100,070.0	Vërtetim nga dokumenti hipotekor
7	Ali Haxhija Emine Haxhija Ahmet Haxhija Fatime Çakiçi Albana Zeneli Anila Mesi					450	12,223	5,500,350.0				5,500,350.0	Vërtetim nga dokumenti hipotekor
8	Esad Bushati	SH-0-6	1/546	30		6	12,223	73,338.0				73,338.0	Konfirmim ZVRPP Shkodër
9	Afrim Bushi Emil Bushi	SH-P-6	1/356-ND	26	25,4		12223	0.0	25.4		745,719	745,719.0	Konfirmim ZVRPP Shkodër
10	Ejell Markaj	SH-P-6	1/23		226	28.75	12,223	351,411.3	28.75		556,661	908,072.3	Vërtetim nga dok. hipotekor
11	Eranda Naim Krymi Nertila Naim Xama	SH-P-6	1/766	37	30	30			60	58,687.5	3,521,250	3,521,250.0	Konfirmim ZVRPP Shkodër
12	Xhaudet Zagoviq	Sh-P-6	1/549	31	68,85	68.85	12223	841,553.6	68.85		2,223,463	3,065,016.6	Konfirmim ZVRPP Shkodër
13	Dritan Allçeniku	Sh-O-6	1/343		26.7	26.7	12223	326,354.1				326,354.1	Konfirmim ZVRPP Shkodër
	Shuma që shpronësohet							**8,620,882**			**17,085,590**	**25,706,471.8**	

KËRKESË

Shtetasja Imelda Spahiu, e datëlindjes 18.6.1978, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu, më 5.5.2005.

KËRKUES
Imelda Spahiu

Korrigjim gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr. 246/2017, datë 24.1.2018, në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 32, datë 29.12.2016, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", bëhet korrigjimi i paragrafit të parë, si më poshtë:

Është: Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për përcaktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Bëhet: "Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara jashtë vendit"", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë